



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ardian Gjini , Kryetar i Komunës së Gjakovës Anton Shala , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić , Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini , Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 30.12.2019 Nr.0-1290
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj , Zyrtare për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gjakovës	
Lloji i aktit:	☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore 01 Nr. 110/04-46963 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Gjakovës

I miratuar më datë: 18.12.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 20.12.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ardian Gjini, gradonačelnik Opštine Đakovica Anton Shala, predsedavajući Skupštine opštine Đakovica	
Cc:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS	Dana: 30.12.2019 Br. 0-1290
Odgovorni službenik:	1. Službenik koji potvrđuje zakonsku procenu 2. Službenik koji izrađuje zakonsku procenu	
	1. Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština 2. Vjosa Ahmetaj, službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštinskog Đakovica	
Vrsta akta:	☐ Uredba Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 za administrativno razmatranje opštinskih akata, na osnovu pravnih nadležnosti ministarstva određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, Pravnom odeljenju i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave dostavljen je sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako je predviđano članom 83 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:



Uredba 01 br. 110/04-46963 o organizaciji i saradnji sa selima, naseljenim mestima i urbanim naseljima na teritoriji opštine Đakovica
Usvojena dana, 18.12.2019. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 20.12.2019. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravne efekte.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo razjašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



R R E G U L L O R E

PËR

ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME
FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE
NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJAKOVËS

Gjakovë, 2019



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA GJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

DI Nr. _____ /2019

DI.18.12.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2 pikën e, në bazë të nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ të MHPJ nr. 02/2019, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenin 9 dhe 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Dlar/D11-10 të dt.26.12.2008, në mbledhjen e mbajtur me dt 18.12.2019 pas diskutimeve hulumt me pikën e 6 të rendit të ditës: Draft Rregullore për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Gjakovës, e miratoi këtë

**RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME
FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE
NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJAKOVËS**

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave të përcaktuara në bazë të ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe formuar keshillat lokale si trupë mbështetëse të organeve të komunës, dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të çdo pogrami dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënia dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Neni 3

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:

1. Këshilli lokal – nënkupton trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
2. Kryetar i këshillit lokal – nënkupton kandidatin e zgjedhur me shumicën e votave të pjesëmarrësve në tubim zgjedhor në fshat, vendbanim dhe lagje urbane.

Neni 4

Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës

1. Për të realizuar që tuta mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Komuna e Gjakovës do të mbështetë zgjedhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarit e këshillave lokale.

2. Numri i këshillave lokale në pjesën e urbanizuar të territorit të Komunës së Gjakovës është si vijon:

1. Këshilli lokal nr.1
2. Këshilli lokal nr.2
3. Këshilli lokal nr.3
4. Këshilli lokal nr.4
5. Këshilli lokal nr.5
6. Këshilli lokal nr.6
7. Këshilli lokal nr.7
8. Këshilli lokal nr.8
9. Këshilli lokal nr.9
10. Këshilli lokal nr.10

3. Numri i këshillave lokale në pjesën e Ruralit të Komunës së Gjakovës është si vijon:

1. Këshilli lokal me seli në Molliq
2. Këshilli lokal me seli në Ponošev
3. Këshilli lokal me seli në Babaj i Bokës
4. Këshilli lokal me seli në Brekoc
5. Këshilli lokal me seli në Rrafoc
6. Këshilli lokal me seli në Sheremet
7. Këshilli lokal me seli në Novosellë të Ujzë
8. Këshilli lokal me seli në Shkëmb
9. Këshilli lokal me seli në Dujakë
10. Këshilli lokal me seli në Doblibare
11. Këshilli lokal me seli në Bec
12. Këshilli lokal me seli në Gernjine
13. Këshilli lokal me seli në Gërgoc
14. Këshilli lokal me seli në Jabllanec
15. Këshilli lokal me seli në Kralan
16. Këshilli lokal me seli në Bistazhin
17. Këshilli lokal me seli në Rëgovë
18. Këshilli lokal me seli në Derran
19. Këshilli lokal me seli në Lipovec
20. Këshilli lokal me seli në Del

4. Në parimdesti që në çdo fshat, vendbanim dhe lagje urbane të zgjedhën këshillat lokale atëherë me këshillat lokale mund të përfaqësojë një e një fshat, ishara, vendbanime apo lagje urbane.

5. Te gjitha ishara, vendbanimeve dhe lagje urbane të çdo përfaqëson në Këshillat Lokale sipas pikës 2 dhe 3 të kësaj neni do të përfaqësohen në Listat e çdo do të jenë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

Neni 5

Formimi i Komisionit nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e Këshillave lokale

1. Kuvendi i Komunës emëron një Komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shpirtë (7) anëtarë: katër (4) anëtarë nga Kuvendi i Komunës, një (1) nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesi e ishara, vendbanimit apo lagjes urbane. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përzierjen e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, duke respektuar kufizimin gjimor. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit.

2. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës duhet të jetë përgjegjës për cakimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve të qytetarëve, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të ishara, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

3. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e ishara, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.

4. Te gjithë qytetarët pjesëmarrës në tubimet zgjedhore mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatohen ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhore. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës është i obliguar që të shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit zgjedhor ti kthejë përgjigje me shkrim qytetarëve që kanë adresuar ankesat.

5. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:

5.1 Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjedhën këshillat lokale;

5.2 mediave lokale;

5.3 nëpërmjet faqes zyrtare të komunës.

6. Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë:

6.1 vendin e ditës;

6.2 datën;

6.3 kohën;

6.4 vendin e mbajtjes së tubimit.

7. Pas përfundimit të procesit zgjedhor të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale, Komisionet e formuara nga Kuvendet e Komunës pushojnë aktivitetin e tyre.

Neni 6

Formimi i këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes

1. Këshilli lokal mund të ketë prej 5 deri në 9 anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill lokal përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
2. Çdo fshat, vendbanim dhe lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal. Në rast kur këshilli lokal ka numër qift të fshatrave, vendbanimeve, lagjesh urbane, atëherë vendbanimi, fshati, lagja urbane me numër më të madh të banorëve jep dy anëtar në këshillin lokal.
3. Këshilla Lokale janë të obliguara që brenda 3 muajve nga data e zgjedhjes së tyre në këshillin lokal të zgjedhin nën-këshilla lokale. Nën-këshilla lokale mund të kenë në (3) deri në pesë (5) anëtar.
4. Përbërja e këshillave lokale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të jetë sipas ligjit për Barazim Gjinorë. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, ata duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal.
5. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës zgjedhin anëtarët e këshillit lokal, me rastin e tubimit të qytetarëve, që mbledh të gjithë banorët e interesuar të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
6. Zgjedhja mund të bëhet përmes votimit të hapur apo votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve. Mënyra e votimit përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
7. Kandidantët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë banor të përhershëm në atë lokalitet.
8. Kandidantët për pozita të anëtarëve dhe të kryetarëve të këshillit lokal, mund të kandidohen nëse janë kryetarë, nënkryetarë dhe sekretarë të subjekteve politike, si dhe anëtar të Kuvendit të Komunës.

Neni 7

Zgjedhja e anëtarëve dhe kryetarit të këshillit lokal

1. Për anëtarë të këshillave lokale zgjedhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, që kandidojnë dhe që janë prezent në tubimin zgjedhor.
2. Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga anëtarët e zgjedhur të këshillit lokal, i cili ka marrë më së shumti vota të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim.
3. Nëse në tubime të njëjta të votimit kemi dy apo më shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë organizohet rrethi dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjidhet për kryetar të këshillit lokal.

4. Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale zgjedhen me mandat 4 vjeçar.
5. Zgjedhjet për këshillin lokal mund të organizohen vetëm nëse janë prezenta shumica e anëtarëve të Komitësit të Komunës për zgjedhjet e këshillave lokale.
6. Tubimet e kanë legjitimitetin juridik nëse në tubime janë prezentë së paku 20 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti.

Neni 8

Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale

1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë që anëtarët ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushur obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë të votave të bamorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me rastin e tubimit publik me qytetarë.
2. Mandati i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon:
 - 2.1 me kryerje të mandatit,
 - 2.2 nëse vdes,
 - 2.3 nëse jep dorëheqje,
 - 2.4 nëse ndërtron vendbanim,
 - 2.5 nëse shkarkohet,
 - 2.6 nëse dënohet për vepra penale.
3. Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe anëtarëve bëhet sipas procedurës së zgjedhjes.
4. Në rast të humbjes së mandatit të kryetarit të këshillit lokal, komisioni komunal brenda 30 ditësh duhet të organizojë zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri.
5. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillave lokale me rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes, gjegjësisht kandidatët që nuk kanë arritë të bëhen anëtarë të këshillit, me aprovimin e komisionit komunal brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Neni 9

Procesverbali nga tubimi zgjedhor

1. Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përmbajë shënime të rëndësishme të numrit të qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurën e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.
2. Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas neni 5 të kësaj rregulloreje i raporton Kryeqendrës të Komunës për njedhjen e tubimeve, për zgjedhjen e këshillave lokale.
3. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve, kryetarit të këshillit lokal duhet të bëhen publikë menjëherë pas tubimit zgjedhor.

Neni 10

Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokale

1. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës thirrë kryetarët e këshillave lokale që të marrin pjesë në tubimet publike me qëllim të në dëgjimit publik për buxhet, tubimet e urgjencës publike, takimet për planifikim strategjik që organizohen nga komuna përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.
2. Në plan të mëtejshëm i këshillit lokal duhet të jetë i përfshirë në të gjitha gëpjet paruese komunale për hartimin e planeve urbane, zhvillimore dhe rurale që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.
3. Kryetari i Komunës duhet që së paku të organizojë dy (2) takime në vit me Kryetarët e këshillave lokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj. Për rendin e ditës duhet të konsultohen edhe Kryetarët e këshillave lokale.
4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal për çështje të caktuara me interes për komunitetin.

Neni 11

Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale

1. Këshilli lokal mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Këshilli lokal organizon, përcjell dhe planifikon planin dhe programet zhvillimore të lokalitetit, në të gjitha sferat në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale.
3. Këshilli lokal duhet të informojë komunitetin për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshilli lokal.
4. Takimet e paqendrës mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal.
5. Këshilli lokal mund të ndërmarrë aktivitetet të cilat në veçanti ndikojnë në:
 - 5.1. zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
 - 5.2. planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
 - 5.3. mirëmbajtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;
 - 5.4. mirëmbajtjen në cilësi të shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
 - 5.5. sigurën të dëbuar elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
 - 5.6. mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave publike të gjelbëruara;
 - 5.7. zhvillimin e turizmit;
 - 5.8. organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
 - 5.9. bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizatën të tjera të shoqërisë civile për çështjet me interes për lokalitetin;

8.19. organizim dhe aksione veprimtare në interes për lokalitetin;

8.11. zbaton akteve të tjera që janë të barta, sipas procedurave në rreth të kësaj rregullatore;

6. Këshillat lokale të fshatrave kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mënyrë të barabartë me bashkitë në territorin e komunës përkatëse.

7. Këshillat lokale mund t'i paraqesin organet e komunës, pyetje me shprehje për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, kurse organet e komunës brenda afatit ligjor të përgjigjen në kërkesën e bërë.

8. Komuna obligohet që t'ia sigurojë hapësirën për mbajtjen e takimeve Këshillave Lokal në objektet publike komunale, në lokalitetin ku gjendet selia e K.L.

Neni 12

Roli i kryetarëve të këshillave lokale

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e komunës.

2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Po ashtu, ai i nënshkruan konkluzionet dhe propozimet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditëve, nga dita e miratimit të tyre t'i dorëzojë të Kryetari i Komunës përmes Zyrtarit Përgjegjës për bashkëpunimin me këshillat lokal.

Neni 13

Marrëveshja e bashkëpunimit

1. Marrëveshja e bashkëpunimit të komunës me fshatin, vendbanimet dhe lagjet urbane, duhet të përmbajë së paku këto elemente:

- 1.1. Objektivat e marrëveshjes;
- 1.2. Kohëzgjatjen;
- 1.3. Përshkrimin e obligimeve për palët;
- 1.4. Dinamikën e realizimit të punëve dhe
- 1.5. Kostot financiare.

2. Objekti i marrëveshjes nuk mund të jetë përgjegjësi e Kryeshtit të Komunës të përcaktuar në nenin 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 14

Miratimi i marrëveshjes të bashkëpunimit

Marrëveshjet të urtit i fshatit komuna me këshillat lokale duhet të miratohen nga Drejtoria përkatëse në komunë.

Neni 15

Kompensimi i këshillave lokale

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës së qipakës.

2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative.

3. Kompenzimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjatësi 150 minuta të këshillit lokal të mbledhur brenda vitit kalendrik.

4. Për të kompenzuar Kryetari i Këshillit lokal duhet të dëshmojë për takimet e mbajtura me listën e nënshkrimeve të pjesëmarrësve, e cila duhet të përmbajë:

4.1. rendin e ditës;

4.2. datën;

4.3. kohën;

4.4. vendin e mbajtjes së tubimit.

Neni 16

Financimi i aktivitetëve

1. Financimi i aktivitetëve të këshillave lokale mund të bëhet nga vet lamoret e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga komuna, nga financimi i përfashkët si dhe nga donatorët, në pajtueshmëri të plotë me Statutin e Komunës së Gjakovës, rregulloret komunale dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.

2. Këshilli lokal harton raporte gjatërmujore dhe vjetore të mjeteve të inkasuar, si dhe atyre të shpenzuar, dhe i bën ato transparente për qytetarët e anij lokaliteti si dhe para organeve komunale.

Neni 17

Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

1. Me hyjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregulloria për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatat, Vendbanimet, dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Gjakovës nr.011-90476/2015, e dt. 30.12.2015.

2. Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjet Lokale dhe Statutin e Komunës mbizotërojnë dispozitat e Ligjit dhe Statutit.

3. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

4. Pjesë përbërës e kësaj rregulloreje janë Listat 1 dhe 2 për Përcaktimin i territorit të Këshillave Lokale.

Neni 18

Kjo rregullore hyj në fuqi pasëmbledhjeve (15) dhe pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Mëdhaimit e Administrimit të Poshetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

Dt. 18.12.2019

(2019)



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Amion Shala

Lista I

Përcaktimi i territorit të Këshillave Lokale në pjesën e urbanizuar (qytetit) të Komunes së Gjakovës

1. Këshilli Lokal nr.1 me seli në Gjakovë, kufizohet duke filluar nga kufiri i anës veriore të ish kombinatit IBT "Emin Duraku", pastaj vazhdon nëpër rrugën "Gjergj Sokoli" dhe "Bardhyl Çaushi", duke përfshirë anën e majtë të tyre, vazhdon gjatë tek kryqëzimi me rrugën "UÇK", vazhdon rrugës "UÇK" duke përfshirë anën e majtë, pastaj vazhdon në anë të rrugës "Veshi Klark" duke e përfshirë anën e majtë të saj së bashku me Bodrumin e Verës dhe Piken e Kamburani në afërsi, prej këtu e për rrugën "Veshi Klark" në drejtim të perëndimit deri tek lumi i Lukës duke vazhduar në këtë drejtim e për rrugën "Mark Malota" dhe vazhdon në drejtim të kufirit të anës veriore të ish Kombinait IBT "Emin Duraku", aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.
2. Këshilli Lokal nr.2 me seli në Gjakovë, kufizohet duke filluar nga vendi "Lugu i Balës", kalhet me rrugën "Kazhima Myezini" duke e përfshirë anën e djathtë të saj, vazhdon në një pjesë të rrugës "Sabirije Vokshi Bija" duke e përfshirë anën e djathtë, vazhdon me rrugën "Demush Lahu" duke e përfshirë anën e djathtë të saj, vazhdon pastaj kah veriu në një pjesë të rrugës "Bajram Curri" duke e përfshirë anën e djathtë, vazhdon ka lindja në një pjesë të rrugës "Dergut Vokshi" duke e përfshirë anën e djathtë, vazhdon në një pjesë të rrugës "Mikë Dorni" duke përfshirë anën e djathtë deri tek lumi Krena, vazhdon në drejtim të rrjedhës së lumit Krena duke e përfshirë anën e djathtë deri në bashkimin me lumit Lrenka, vazhdon përputhë lumit Lrenka deri tek lokatieri "Rripa", gjeografisht kufiri i Zonës Kadastrale Gjakovë - Jashë Qytet nga ana perëndimore e qytetit, duke e përfshirë lokalitetin e "Rripës", një pjesë të kodrës së "Cabrani" e duke vazhduar nga veriu deri tek "Lugu i Balës", aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.
3. Këshilli Lokal nr.3 me seli në Gjakovë, kufizohet duke filluar prej "Ures së Namazgjasë", në lumit Krena, vazhdon rrugës "Abedin Terbasli", duke përfshirë anën e djathtë deri tek rruga "Nëna Terziu", vazhdon nga jugu në një pjesë të rrugës "Nëna Terziu", duke përfshirë anën e djathtë të rrugës deri tek udhëkryqi me rrugën "Musa Zaimi", vazhdon pastaj kësaj rruge duke përfshirë anën e djathtë të saj deri tek udhëkryqi me rrugën "Elton Zherka", vazhdon në një pjesë të rrugës "Elton Zherka" duke përfshirë anën e djathtë, vazhdon rrethimor nga ana perëndimore e lindore e SHIFMU "Emin Duraku" duke përfshirë anën e djathtë të tyre deri tek udhëkryqi me rrugën "Naser Brahimi" vazhdon në një pjesë të kësaj rruge duke përfshirë anën e djathtë deri tek udhëkryqi me rrugën "Ali Pashë Tepcleni", vazhdon rrugës "Ali Pashë Tepcleni" duke përfshirë anën e djathtë deri tek kryqëzimi me rrugën "Avdullah Baballia", vazhdon në lindje drejt lumit Llukac dhe rruges "Behije Dashi" duke përfshirë anën e djathtë deri tek kufiri i Planit Rregullues "Rezina" për të vazhduar në drejtim të jugut deri në kryqëzimin me rrugën "Gaspër Karaqi", duke përfshirë kompleksin e ish Ndërmarrjes "Virgjinia", vendbanimin "Ali Ibra" dhe objektet e banimit të lokacionit "Mulliri i Zekës", vazhdon pastaj rrugës "Gaspër Karaqi" duke përfshirë anën e djathtë deri tek lumi Llukac, vazhdon rrugës "Skenderbeu" duke përfshirë anën e djathtë deri në udhëkryqin me rrugën "Khaler Lipoveci" duke përfshirë anën e djathtë, vazhdon rrugës "Sadedin Sheta" duke përfshirë anën e djathtë, pastaj vazhdon rrugës "Haki Lahu" duke përfshirë anën e djathtë, e për rrugën pastaj rrugën "Xheladin Hani" për të vazhduar deri tek lumi Krena (Ura e Tablanecës), vazhdon pastaj

përpjetë lumit deri tek "Ura e Namazgjasë", aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.

4. Këshilli Lokal nr.4 me seli në Gjakovë, kufizohet duke filluar nga ana veriore me rrugën "UÇK", duke përfshirë anën e djathtë të kësaj rruge deri tek lumi Llukac, vazhdon rrugës "Vesli Isllak" deri tek e ashpërqimja "Pika e /e/ë" duke përfshirë anën e djathtë, kthehet nga jugu duke u kufizuar me vijën e Planit Rregullues "Rezinë" duke përfshirë anën e djathtë, kthehet nga perëndimi nëpër rrugën "Behije Dashi" duke përfshirë anën e djathtë deri tek lumi Llukac, vazhdon deri tek kryqëzimi me rrugën "Ali Pashë Lepetena" duke vazhduar në një kësaj rruge deri tek udhëkryqi me rrugën "Naser Brahmanaj" vazhdon në një pjesë të kësaj rruge duke përfshirë anën e djathtë, për të vazhduar përgjatë rrethimit jugor e perëndimor të SH/MU "Emin Duraku" duke përfshirë shkollën dhe Qendrën e Mjekësisë Familjare, deri tek kryqëzimi me rrugën "Liron Zherka", vazhdon në një pjesë të kësaj rruge deri tek udhëkryqi me rrugën "Musa Zajmi", nga këtu vazhdon rrugës "Musa Zajmi" duke përfshirë anën e djathtë deri në kryqëzimin me rrugën "Nëna Tereze" duke përfshirë anën e djathtë dhe nga këtu vazhdon pishaj rrugës "Abedin Lërbeshi" duke përfshirë anën e djathtë deri tek "Ura e Namazgjasë" mbi lumina Krena, vazhdon përpjetë lumit Krena duke përfshirë anën e djathtë të lumit deri tek "Ura e Islam Begut", vazhdon rrugës "Ismail Qemali" duke përfshirë anën e djathtë deri tek udhëkryqi me rrugën "UÇK" aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.

5. Këshilli Lokal nr.5 me seli në Gjakovë (nëpër Dardënia), kufizohet duke filluar në veri nga kufiri me Ishutin Osek Hylë dhe përfshinë territorin në dy anët e rrugëve "Sylejman Abdyl" dhe "Dëshmorët e Herëqit", duke vazhduar nga ana perëndimore deri te lumi Krena, vazhdon njëdrejtë së lumit Krena deri tek Ura në afërsi të Fabrikës së Tjergullave, vazhdon në një pjesë të rrugës "Elez Miftari" deri tek udhëkryqi me rrugën "Gjergj Sokoli", vazhdon nëpër të mëtej duke përfshirë anën e majtë deri tek kufiri i anës veriore të ish kombinatit IBI "Emin Duraku", e prentë rrugën "Mark Malota" dhe vazhdon në drejtim të lumit Llukac, vazhdon përpjetë lumit Llukac deri në perëndim të rrugës "Mark Malota" të cilën e prentë perseri dhe vazhdon nga veriu deri tek kufiri i Ishutit Osek Hylë duke e përfshirë anën e majtë të kësaj vije e cila përfundon pas objektit të ish fabrikës së Tjergjeve gjegjësisht pikës së karburantit, aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.

6. Këshilli Lokal nr.6 me seli në Gjakovë, kufizohet duke filluar në anën veriore prej udhëkryqit të rrugëve "Gjergj Sokoli" dhe "Elez Miftari", vazhdon rrugës "Gjergj Sokoli" duke përfshirë anën e djathtë të kësaj rruge, vazhdon rrugës "Bardhyl Çausht" duke përfshirë anën e djathtë të saj, vazhdon në një pjesë të rrugës "Ismail Qemali" duke përfshirë anën e djathtë deri tek "Ura e Islam Begut", vazhdon përpjetë lumit Krena deri tek Ura në rrugën "Yllka Domi", vazhdon në një pjesë të rrugës "Yllka Domi" duke përfshirë anën e djathtë, nga këtu vazhdon rrugës "Dërgut Vokshi" duke përfshirë anën e djathtë deri tek kryqëzimi me rrugën "Bajram Curri", vazhdon nga jugu në një pjesë të rrugës "Bajram Curri" duke përfshirë anën e djathtë deri tek udhëkryqi me rrugën "Dërgut Taba", vazhdon rrugës "Demush Taba" duke përfshirë anën e djathtë deri tek udhëkryqi me rrugën "Sabrie Vokshi Bija", vazhdon në një pjesë të kësaj rruge duke përfshirë anën e djathtë, vazhdon në drejtim të rrugës "Mazliron Myezini" dhe vendit "I nga i Balës" duke përfshirë anën e djathtë të tyre për të vazhduar nëpër Çoban përbi rrethojave të "Varezeve të Klaritëve" dhe më tutje në veri deri tek Fabrika e Tjergullave duke përfshirë rrethojat e kësaj fabrike dhe duke përfunduar me kryqëzimin e rrugëve "Gjergj Sokoli" dhe "Elez Miftari", aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.

7. Këshilli Lokal nr.7 me seli në Gjakovë, kufizohet duke filluar prej kryqëzimit të rrugëve "Skenderbeu" e "Xhatur Lipovceci" dhe përfshinë anën e djathtë të rrugës "Skenderbeu" deri tek Ura e lumit Llukac, vazhdon rrjedhës së lumit deri në drejtim me rrugën "Jashar Salihu" e "Faik Komica" deri te ndërkryqi me rrugën "Fsat Stavileci" duke përfshirë anën e djathtë të tyre, pastaj vazhdon në drejtura të verit në rrugën "Fsat Stavileci" dhe "Pajazit Nushi" duke e përfshirë anën e djathtë të tyre deri në kryqëzimin me rrugën "Sadëdin Shehu" dhe "Xhatur Lipovceci", për të vazhduar nga këtu deri tek kryqëzimi i rrugëve "Skenderbeu" dhe "Xhatur Lipovceci", aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.
8. Këshilli Lokal nr.8 me seli në Gjakovë, kufizohet duke filluar nga "Ura e Tabllaneve", nbi lumit Krena për të vazhduar në një pjesë të rrugës "Xheladin Hani" duke përfshirë dy anët e saj, për të vazhduar rrugës "Haki Ibra" duke përfshirë anën e djathtë, deri tek ndërkryqi me rrugën "Sadëdin Shehu" duke përfshirë po ashtu anën e djathtë deri tek ndërkryqi me rrugën "Pajazit Nushi", vazhdon nga jugu rrugës "Pajazit Nushi" dhe rrugëve "Fsat Stavileci" e "Ymer Pula" duke përfshirë anën e djathtë të tyre deri tek Ura nbi lumit Ereniku, vazhdon përpjetë lumit Ereniku deri tek bashkimi i lumënjëve Ereniku dhe Krena, vazhdon përpjetë lumit Krena deri tek "Ura e Tabllaneve", aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.
9. Këshilli Lokal nr.9 me seli në Gjakovë, kufizohet duke filluar prej "Urrës së Tabakëve", nbi lumit Ereniku vazhdon rrjedhës së këtij lumi deri në bashkimin me lumit Vogovice, vazhdon përpjetë lumit Vogovice, pastaj nga këtu përmë rrugën "S. Philli (1999)" e "Domienik Përzegaj" deri në kufizim me oborrin e SHM U "Zef Lash Marku" duke e përfshirë dhe shkodrën, vazhdon në perëndim duke e përfshirë pronën e ish Kooperativës Bujqësore, kompleksin e urbanizuar "Lagja Brekoc", vazhdon në veri deri tek rruga "Minatori" të cilën e pret për të vazhduar kufirit në veri të Varrësve deri tek lumi Ereniku, vazhdon rrjedhës së lumit Ereniku deri tek "Ura e Tabakëve", aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.
10. Këshilli Lokal nr.10 me seli në Gjakovë, kufizohet duke filluar në kryqëzimin e rrugëve "Faik Komica" dhe "Ymer Pula", vazhdon në lindje përgjatë rrugëve "Faik Komica" e "Jashar Salihu" duke përfshirë anën e djathtë të tyre deri në lumit Llukac, vazhdon përpjetë lumit Llukac deri tek Ura në rrugën "Gaspër Karaqi", vazhdon pastaj në lindje përgjatë rrugëve "Gaspër Karaqi" e "Doli Polloshka" duke e përfshirë anën e djathtë të tyre së bashku me Kompleksin Industrial Jagor deri tek kufiri i ri i zonës urbane, kthëhet në anën jugore deri tek lumi Ereniku për të vazhduar përpjetë rrjedhës së lumit deri tek Ura në rrugën "Ymer Pula", nga këtu vazhdon në veri përgjatë rrugës "Ymer Pula" duke e përfshirë anën e djathtë dhe përfundon tek kryqëzimi me rrugën "Faik Komica", aty ku edhe fillon kufizimi i këtij Këshilli Lokal.

Lista 2

Përshkrimi i territoreve të Këshillave Lokale në pjesën e rurale (fshatrave) të Komunës së Gjirkovës

1. Këshilli Lokal me seli në fshatin Mulliq i përshkruan këto fshatra: Mulliq, Bimoshë, Koshare, Brevinë dhe Navolaz.
2. Këshilli Lokal me seli në fshatin Ponoshë i përshkruan këto fshatra: Ponoshë, Morinë, Stubi, Berfahë, Smolice, Papoc, Stishmon dhe Nee.
3. Këshilli Lokal me seli në fshatin Babaj Bokës i përshkruan këto fshatra: Babaj Bokës, Guskë, Devë, Korenicë dhe Duzhje.
4. Këshilli Lokal me seli në fshatin Breckoc i përshkruan këto fshatra: Brekoc, Vogove, Zhitë, Zyllaj, Firzë, Meje, Orze dhe Jaboc.
5. Këshilli Lokal me seli në fshatin Ramoc i përshkruan këto fshatra: Ramoc, Rripaj dhe Modanq.
6. Këshilli Lokal me seli në fshatin Sheremet i përshkruan këto fshatra: Sheremet, Kracaj, Dullashaj, Dobrosh dhe Pucaj.
7. Këshilli Lokal me seli në fshatin Novosellë të Urit i përshkruan këto fshatra: Novosellë e Urit, Novosellë e Epërme, Palahadhi, Tralamuj, Osek Pasha, Janoshi, Bresha.
8. Këshilli Lokal me seli në fshatin Skivjan i përshkruan këto fshatra: Skivjan, Osek Hile dhe Plangor.
9. Këshilli Lokal me seli në fshatin Dujakë i përshkruan këto fshatra: Dujakë, Hercep, Dobrigje dhe Firaj.
10. Këshilli Lokal me seli në fshatin Doblibare i përshkruan këto fshatra: Doblibare, Bëdencara, Vranqi.
11. Këshilli Lokal me seli në fshatin Bec i përshkruan këto fshatra: Bec, Lughumaj, Qerim, Zhdrofë, Sopot.
12. Këshilli Lokal me seli në fshatin Cërnjan i përshkruan këto fshatra: Cërnjan, Meqe, Kodrah, Rashkoc, Rakovinë, Nete.
13. Këshilli Lokal me seli në fshatin Gërgoc i përshkruan këto fshatra: Gërgoc, Rakoci, Zhabeli, Bardhamaj.
14. Këshilli Lokal me seli në fshatin Jablaniçë i përshkruan këto fshatra: Jablanica, Lloguqija.
15. Këshilli Lokal me seli në fshatin Krejan i përshkruan këto fshatra: Krejan.

16. Këshilli Lokal me seli në fshatin Bishtazhin i përfshinë këto fshatra: Bishtazhin, Maromë, Koshavec, Smau, Viz, Rezine.

17. Këshilli Lokal me seli në fshatin Rugovë e përfshinë fshatin: Rugovë.

18. Këshilli Lokal me seli në fshatin Demjan i përfshinë fshatin: Demjan.

19. Këshilli Lokal me seli në fshatin Lipovë i përfshinë këto fshatra: Lipovë, Gëzgjë dhe Goden.

20. Këshilli Lokal me seli në fshatin Dol i përfshinë këto fshatra: Dol, Raçe, Mogleçë, Kozarë dhe Pjetershan.

KËSHILLAT LOKALE TE PËRSES URBANE DHE RURALE TE KOMUNES SE GJAKOVES

